



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:048948
Datë: 20.08.2024
Numri i dokumentit: 06067079

C.nr.226/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, duke vendosur në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit F.M nga Gjilani, rr “...”nr...., ndaj të paditurëve N.Ll nga Gjilani, rr.”...” nr...., D.K nga fsh...., K...., ...më parë nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, S.D, K.D, K.D dhe Xh.D, të gjithë më parë nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, dhe S.Tme vendbanim në ..., për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes dhe kthimi i paluejtshmërisë. Vlera e kontestit 1500€, jashtë seancës gjyqësore me datë 20.08.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Ndërprehet procedura kontestimore sipas padisë së paditësit F.M nga Gjilani, ndaj të paditurëve N.Ll nga Gjilani, D.K nga fsh...., K...., ...më parë nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, S.D, K.D, K.D 2 dhe Xh.D, të gjithë më parë nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, dhe S.Tme vendbanim në ...-Komuna e Gjilanit, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes dhe kthimi i paluejtshmërisë, vlera e kontestit 1500€, për shkak të vdekjes së paditësit F.M nga Gjilani.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit F.M e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi F.M nga Gjilani, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes dhe kthimi i paluejtshmërisë, vlera e kontestit 1500€, ndaj të paditurëve N.Ll nga Gjilani, rr.”...” nr...., D.K nga fsh...., K...., ...më parë nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, S.D, K.D, K.D 2 dhe Xh.D, të gjithë më parë nga Gjilani, tani në adresë të panjohur, dhe S.Tme vendbanim në

Gjykata, ka konstatuar se paditësi F.M ka ndrruar jetë, e ky fakt konstatohet nga gjyqtari i qështjes, ngase është në fqinjësi me paditësin.

Andaj, duke pasur parasysh faktin se paditësi F.M nuk është në jetë, gjykata në mbështetje të nenit 277 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ku shprehimisht është përcaktuar se “*Procesi gjyqësor ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose humb zotësinë procedurale*”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR ÇËSHTJE CIVILE**

2023:048948, 20.08.2024

Numri i lëndës: NumriLëndës
Datë: DataDokumentit
Numri i dokumentit: NumriDokumentit

Gjyqtari
Berat Spahiu

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.